

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B.K, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.652/2016 të datës 03.01.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.337/2018 të datës 26.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19 dhjetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit B.K, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.652/2016 të datës 03.01.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.337/2018 të datës 26.10.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.652/2016 të datës 03.01.2018, i dënuari B.K është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 150 (njëqindpesëdhjetë) €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, kurse e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA.1nr.337/2018 e datës 26.10.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit dhe përfaqësuesit të tij ligjor - prindit të tij T.K. dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur i dënuari, pa përcaktuar bazën dhe propozimin e kërkesës.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.237/2018 e datës 17.12.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë i dënuari, pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është bazuar në spekulimin në procesverbalin e përpiluar në zyrën e KEDS-it në Prizren nr.0902300 i datës 08.10.2015 e i cili ishte punuar shumë muaj më vonë se data e shënuar dhe kinse i dënuari ka nënshkruar pa asnjë konstatim.

Pretendohet se në seancën fillestare të datës 13.04.2017, përjashtohet babai i të dënuarit nga seanca gjyqësore, për shkak të mospajtimit të tij rreth një rasti tjetër me të njëjtin gjyqtar. Po ashtu babai i të dënuarit është përjashtuar edhe nga shqyrtimi gjyqësor i datës 03.01.2018, me rastin e dëgjimit të ekspertit dhe kjo me qëllim të vetëm që të mos mund të bënte pyetje ekspertit pasi që të njëjtit i mungonte një analizë e rastit.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Edhe pse i dënuari në kërkesë nuk ka paraqitur bazë konkrete, bazuar në referatin e kërkesës së tij del se pretendohet në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë përkitazi me faktin se procesverbali i KEDS-it në Prizren nr.0902300 i datës 08.10.2015 është përpiluar disa muaj më vonë dhe jo në datën e përpilimit. Mirëpo bazuar në të dhënat e procesverbalit del se i njëjti është përpiluar në fshatin Z., komuna e P. më datë 08.10.2015, në të cilin procesverbal është konstatuar se një kabllo me lidhje direkte jashtë njësorit elektrik e dokumentuar edhe me fotografitë e bëra në vendin e ngjarjes, për më tepër e nënshkruar nga tre persona të autorizuar dhe të identifikuar me numra të kartelave të punës dhe po ashtu i nënshkruar edhe nga vet konsumatori, të cilat fakte përjashtojnë mundësinë që procesverbali të jetë përpiluar më vonë siç pretendon paraqitësi i kërkesës.

Pretendimi përkitazi me faktin se gjykata e shkallës së parë pa të drejtë ka përjashtuar nga publiku babain e tij në shqyrtimin fillestar të datë 13.04.2017 dhe shqyrtimin kryesor të datës 03.01.2018 nuk paraqet shkelje të procedurës penale, meqë nga procesverbali i shqyrtimit fillestar del se përjashtimi i T.K., është bërë për shkak të prishjes së rendit në gjykatë. Megjithatë, gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të të dënuarit në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.06.2017 në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar T.K., përkitazi me rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale. Mirëpo, bazuar në faqen e dytë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 03.01.2018, gjatë elaborimit të ekspertizës nga ana e ekspertit, për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme dhe pas vërejtjeve për mos ndërhyrje është bërë largimi i T.K., nga shqyrtimi gjyqësor. Nga kjo del se largimi i T.K. nga gjykatorja nuk paraqet shkelje të procedurës penale pasi që largimi i tij është bërë për shkak të prishjes së rendit në gjykatë dhe për më tepër, pasi që i njëjti ka paraqitur dëshminë e tij dhe gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimet të saj ka vlerësuar edhe dëshminë e tij në kontest të provave tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. T.K., duke qenë dëshmitar e jo palë në procedurë, as që ka pas të drejtë të parashtrroj pyetje ekspertit.

Pjesa tjetër e kërkesës së të dënuarit edhe pse nuk i referohet specifikisht, bazës ligjore megjithatë përmes referatit të paraqitur në kërkesë kuptohet se është ushtruar për shkak të konstatimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës, nuk i shqyrtoj këto pretendime, në kuptim të dispozitës se nenit 432 par.2 të KPPK-së.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.335/2018, më 19 dhjetor 2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka